

Një vit nga zgjedhja e dy Mitropolitëve të Kishës Orthodoxke Autoqefale të Shqipërisë



Më 16 shtator 2025, Sinodi i Shenjtë i Kishës Orthodoxke Autoqefale të Shqipërisë, nën drejtimin e Fortlumisë së Tij, Kryepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe të Gjithë Shqipërisë, Joanit, mori një vendim të rëndësishëm për jetën dhe shërbesën e Kishës; zgjedhjen e Hirësisë së Tij Nathanailit si Mitropolit të Gjirokastrës dhe të Hirësisë së Tij Anastasit si Mitropolit të Korçës.

Dy Mitropolitët kanë vijuar shërbesën e tyre baritore, duke u kujdesur, forcuar dhe barituar komunitetet orthodoxke në Mitropolitë e Shenjta që u janë besuar.

Në këtë përvjetor i lutemi Perëndisë t'u japë dy Mitropolitëve tanë urtësi, shëndet, forcë dhe hir për të vazhduar me përkushtim misionin e tyre kryepriftëror.

Për shumë vjet!

[Radio "Ngjallja"](#)